



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:236236

Datë: 31.10.2023

Numri i dokumentit: 04855789

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.787/21

GJYKATA THEMELORE PEJË- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Leon Përlaska dhe procesmbajtësen Shpresa Kërnya, në çështjen penale kundër të pandehurit S. G. , për shkak të veprës penale Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 395 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II.nr.1873/2021 të datës 22.10.2021, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 26.10.2023, në prezencë të prokurores së shtetit Muharrem Bajraktari, si dhe i pandehuri S. G. dhe mbrojtësi sipas detyrës zyrtare Av.Abedin Ademaj, të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 27.10.2023 përpiloi këtë :

AKTGJYKIM

I pandehuri:

S. G. , i lindur me dt. ne D., tani me vendbanim në rr. “A.K.” nr. ..në Pejë, i biri i H. dhe nënës Z. e gjinisë D., i martuar, i identifikuar nga nr. personal, shqiptar, shtetas i R. Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Me dt. 19.11.2020 në Pejë, me dashje vë në lajthim organin kompetent dhe atë Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve që në një dokument publik të vërtetojë një çështje të pavërtetë, të paraparë për të shërbyer si provë në një çështje ligjore dhe të njëjtin e përdorë edhe pse e di që është i rremë, në atë mënyrë që, i pandehuri paraprakisht manipulon numrin identifikues të automjetit nga numri origjinal duke rishtypur numrin Ëvuzzz....., ashtu që më pas shkon në qendrën e lartcekur, ku QRA për veturën A. ..i lëshon lejen e qarkullimit me nr. CRAme targa 03-...-..., me ç’rast pas ekzaminimit të numrit të karrocerisë është konstatuar se në pllakën metalike ku është shtypur numri i karrocerisë ëVUZZZ..... është salduar në mënyrë jo të

rregulltë, pra është manipuluar duke ju prerë pllaka metalike ku ishte i shtypur numri origjinal dhe duke ju vendosur (salduar) në të njëjtin vend pllaka ekzistuese,

- me këtë ka veprën penale “Legalizim i përmbajtjes së rreme” nga Neni 395 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së,

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

- Të pandehurit S. G. i shqipton:

DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, si dhe DENIM ME GJOBW në lartësi prej 500 (pesëqind) euro te cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 vitesh, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- Konfiskohet 1. Vetura e tipit A. ..., ngjyrë hiri metalik me targa 03-...-... me numër te karrocërisë ëVUZZZ..... ne emër te S. G. , 2. Çelësat e veturës dhe 3. CRA me numër
- Obligohet i dënuari qe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

ARSYETIM

- Historiku i çështjes, qëndrimet e palëve dhe fajësia ;

Prokuroria Themelore në Pejë pranë kësaj gjykatë ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1873/2021 të datës 22.10.2021, kundër të pandehurit S. G. për shkak të veprës penale Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 395 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata me datë 26.10.2023, e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën seancë prezantuan prokurorja e shtetit Muharrem Bajraktari, si dhe i pandehuri S. G. dhe mbrojtësi sipas detyrës zyrtare Av.Abedin Ademaj.

Pasi që gjykata u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën dhe veprën penale për të cilat akuzohet e ftoi të njëjtin që të deklarohet në lidhje me akuzën, ku i pandehuri e pranoi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë.

Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri, gjykata e mori mendimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të të pandehurit në lidhje me pranimin e fajësisë të cilët i propozuan gjykatës që të aprovohet pranimi i fajësisë.

Gjykata duke u bazuar në nenin 242 par 2 dhe 6 të KPPRK-së vlerësoj se plotësohen kushtet ligjore për pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike, andaj gjykata e aprovoj pranimin e fajësisë si të tillë.

- Vendimi në lidhje me dënimin;

Gjykata kur vendosi në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit të përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në nenet 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074), dhe atë duke pasur parasysh qëllimin e dënimit, rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të nxjerra nga faktet e çështjes dhe duke aplikuar udhëzuesin për politikë ndëshkimore të Gjykatës Supreme të Kosovës, si në vijim.

Kur vendosi në lidhje me dënimin kryesor gjykata u mbështet në nenin 40 par.1 pika 1.2 dhe nenin 42 par.1 si dispozita të përgjithshme dhe dispozitën e veçantë nga neni 395 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) që e përcakton veprën penale dhe dënimin për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri.

Duke pasur parasysh se në këtë çështje penale i pandehuri e pranoi fajësinë në fillim të shqyrtimit fillestar, gjykata nuk e pati mundësinë që të administroj provat e propozuara në aktakuzë, megjithatë me rastin e vlerësimit të pranimit të fajësisë dhe pas shikimit të shkresave të lëndës

nga provat e bashkëngjitura dhe deklaratimet e palëve në seancën e shqyrtimit fillestar gjykata arriti që të nxjerr rrethanat të cilat janë përcaktuese për llojin dhe lartësinë e dënimit.

Në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit prokurori i shtetit deklaroi " Me qenë se i akuzuari e deklaroi fajësinë Konform kushteve ligjore të parapara me nenin 242 të KPPRK-së, nga Gjykata kërkoj që të njëjtin ta shpall fajtor, ta dënoj si pas ligjit si dhe ta obligoj në paguarjën e shpenzimeve të procedurës penale. Ndërsa me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese, konsideroj se për shkak të sjelljes së tij edhe me një dënim të kushtëzuar do të arrihet qëllim i dënimit ”.

Mbrojtësi i të pandehurit av. Abedin Ademaj deklaroi " Meqenëse i pandehuri e pranoi fajësi, është hera e parë që ka kryer veprën penale, gjendja e tij si pensioner, kërkoj që të merren si rrethanë lehtësuese dhe të njëjtit ti shqiptohet një dënim sa më i lehtë i mundshëm.

I pandehuri, deklaroi "Më vjen shumë keq për këtë rast që ka ndodhë dhe e shpreh pendimin e thellë para gjykatës ”.

Pas analizimit të provave të lartpërmendura dhe deklaratimeve të palëve, gjykata nuk gjeti rrethana rënduese për të pandehurin, ndërsa si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata gjeti, pranimin e fajësisë nga i pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar dhe keqardhja e shfaqur nga i pandehuri, si rrjedhojë gjykata vlerësoj rrethanat rënduese dhe lehtësuese secilën veçanërisht dhe të gjitha së bashku, raportin dhe ndikimin e tyre në njëra tjetrën dhe në kontekst të qëllimit të dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe erdhi në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në nenin 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074).

- Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49,61 ,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të çështjes.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet, e në këtë rast gjykata

ndaj të pandehurit vendosi që të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 (dy) vitesh, që do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin nuk kemi fare rrethana renduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar dhe keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit të dënimit me burgim gjykata u bazua në nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.1 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit më kusht ndaj të pandehurit do të arrihet të realizohet në tërësi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurit, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit . Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej dy (2) vitesh, do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandaloj të pandehurin në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.1 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, e në këtë rast siç u përshkrua me lartë për veprën penale që është shpallur fajtor i pandehuri është paraparë mundësia e shqiptimit të dënimit me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.

Kur u vendos për konfiskimin e veturës gjykata u bazua në nenin 276 dhe 277 të KPRK-së.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të

parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale te ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 450 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Andaj, duke u mbështetur në fakte, provat dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal
P.nr.787/21, me datë 27.10.2023

Procesmbajtësja:
Shpresa Kërnya

Gjyqtari i vetëm gjykues:
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.